



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:086961  
Datë: 07.06.2024  
Numri i dokumentit: 05797858

KPPP.nr.1573/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Alim Sanayi Ticaret” A.S e përfaqësuar nga N.A., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Violeta Jashari avokate nga Prishtina, kundër debitorit “Ardi Com” O.P., me NUI:810779217, me seli në Podujevë, Magjistratja p.n., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Fetije Uka Islami avokate nga Prishtina B. diellit, Rr.”Qamil Balaj”, H 9-të, kati përdhese, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.014/22 të datës 24.01.2022, të Përmbartuesit Privat Rezarta Metaj me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 07.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “Ardi Com” O.P., ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr.014/22, i lejuar me datë 24.01.2022 nga Përmbartuesi Privat Rezarta Metaj, Bujupaj, ANULOHET.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar Urdhrit Përmbartimor P.nr.014/22 të datës 24.01.2022, me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të dokumentit të besueshëm faturës me numër 012065 të datës 01.02.2017; faturës me numër 012076 të datës 08.02.2017, faturës me numër 012082 të datës 17.02.2017; faturës me numër 012083 të datës 17.02.2017, faturës me numër 012095 të datës 24.02.2017, faturës me numër 012097 të datës 24.02.2017, fatura me numër 012108 e datës 09.03.2017; fatura me numër 012109 e datës 09.03.2017; fatura me numër 012117 e datës 17.03.2017; fatura me numër ALM2017000000119 e datës 17.10.2017; fatura me numër ALM2017000000120 e datës

17.10.2017; fatura e datës ALM2017000000122 e datës 18.10.2017; fatura me numër ALL201700000012 e datës 25.10.2017; fatura me numër ALM2017000000128 e datës 25.10.2017; fatura me numër ALM2017000000129 e datës 26.10.2017; fatura me numër ALM2017000000130 e datës 26.10.2017; fatura me numër ALM2017000000141 e datës 11.11.2017; fatura me numër ALM2017000000140 e datës 11.11.2017; fatura me numër ALM2017000000139 e datës 11.11.2017; fatura me numër ALM2017000000146 e datës 24.11.2017; fatura me numër ALM2017000000145 e datës 24.11.2017; fatura me numër ALM2017000000147 e datës 24.11.2017; fatura me numër ALM2018000000010 e datës 19.11.2018; fatura me numër ALM2018000000015 e datës 26.01.2018; fatura me numër ALM2018000000016 e datës 26.01.2018; fatura me numër ALM208000000016 e datës 26.01.2018; fatura me numër ALM2018000000027 e datës 13.02.2018; fatura me numër ALM2018000000028 e datës 13.02.2018; fatura me numër ALM2018000000044 e datës 01.03.2018; fatura me numër ALM2018000000045 e datës 01.03.2018; fatura me numër ALM2018000000079 e datës 04.05.2018; fatura me numër ALM 2018000000108 e datës 02.07.2018, ka lejuar Urdhrin Përmbarimor P.nr.014/22 të datës 24.01.2022, me të cilin është urdhëruar debitori, me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që në emër të borxhit sipas faturave të lartcekura, t'ia paguaj shumën prej 236,474.67 €, me kamatë ligjore prej 8 % duke e llogaritur nga data kur është bërë e arritshme e deri në pagesën definitive, dhe të gjitha shpenzimet që do dalin gjatë procesit, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë, të bëhet regjistrimi, vlerësimi, sekuestrimi dhe shitja e pronës së paluajtshme dhe shitja e tyre të paguhet detyrimi nga ana e debitorit.

Debitori ka parashtruar prapësim përmes të cilit e kundërshton në tërësi urdhrin përmbarimor si të pa bazuar, pasi që propozimi për përmbarim është në kundërshtim të plotë me nenin 36 të LPP-së, meqenëse i njëjti nuk ka vepruar sipas këtij neni gjykata me aktvendim duhet ta anuloj urdhrin përmbarimor, ndër të tjerash ka theksuar se debitori nuk ka vepruar në kuptim të dispozitave ligjore, po ashtu nga fakti se debitori në bazë të faturave sipas pasqyrës të shënuara në propozim nuk janë korrekte dhe jo të sakta e në veçanti jo reale nga fakti se debitori ka bërë pagesa dhe i ka përmbush obligimet me rastin e pranimit të mallit sipas marrëveshjes gojore. Ka shtuar se kërkesa e kreditorit për përmbushjen e borxhit nuk është real nga fakti se shumica nga ky borxh si më lartë është paguar. Duke u bazuar në të lartcekurat i ka propozuar gjykatës që të aprovoj prapësimin si të bazuar.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar prapësimin si të pas afatshëm, i pa qartë dhe i pa mbështetur në asnjë provë relevante. Ka shtuar se prapësimi është i pas afatshëm pasi që urdhrin përmbarimor e ka pranuar në muajin shkurt ndërsa prapësimin e ka ushtruar në muajin prill, e që nënkupton se prapësimi është ushtruar dy muaj pas afatit. Më tutje ka theksuar se debitori nuk e ka kontestuar borxhin dhe se transferet bankare të paraqitura nuk përputhen me faturat të cilat debitori i ka borxh kreditorit nga se transferet janë shuma të paguara të cilat janë paguar për faturat përkatëse e jo për faturat që tani kërkon përmbarim. I ka propozuar gjykatës që urdhrin përmbarimor ta njeh dhe ekzekutoj sipas dispozitave ligjore, si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të palëve, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (në tekstin e mëtejshëm: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar andaj të njëjtin e aprovoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Sipas vlerësimit të Gjykatës, debitori Urdhrin Përmbarimor P.nr.014/22 të datës 24.01.2022, të Përmbaruesit Privat Rezarta Metaj, e ka pranuar me datë 08.04.2022, e cila vërtetohet nga fletë kthesa për dorëzim personal të përmbaruesit privat që gjendet në shkresat e lëndës, ndërsa prapësimi nga ana e debitorit është ushtruar me datën 13.04.2022.

Gjykata vlerëson se organi përmbarues ka lejuar përmbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit

1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Sipas nenit 17 të LPP-së, përcaktohet se *“Në procedurën përbarimore përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën kontestimore, po qe se me këtë ligj ose me ndonjë ligj tjetër nuk parashihet diçka tjetër”*, lidhur me nenin 331.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore në të cilin përcakton se *“Çdo palë ndërgjyqëse detyrohet kryesisht të paraqesë shkresat që ka përdorur për të provuar thëniet e veta”* dhe 331.2 *Së bashku me shkresën e hartuar në gjuhë të huaj paraqitet edhe përkthimi i legalizuar nga ana e përkthyesit gjyqësor të përhershëm.*

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura e lartcekura në bazë të cilave është lejuar urdhri për përbarim, nuk i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 29, 37, 17 të LPP-së lidhur me nenin 331 par.1 dhe 2 të LPK-së.

Në shkresat e lëndës gjykata gjeti se dokumentet – faturat në bazë të cilëve është lejuar propozimi për përbarim nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokumente i besueshme, për faktin se faturat dokumentet përbarimor, mbi bazën e së cilëve është lëshuar urdhri përbarimor, janë në gjuhë të huaj dhe të njëjtat nuk janë përkthyer në ndonjërin nga gjuhët zyrtare të përcaktuara sipas dispozitave ligjore.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat Gjykata vlerëson se në rastin konkret dokument i besueshme, mbi të cilat mbështetet propozimi për përbarim, e mbi bazën e të cilit Përbaruesi privat ka lejuar përbarimin, nuk kanë tipare të përbarueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përbaruesit duhet të anulohet.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të palëve të paraqitura në prapësim dhe përgjigje në prapësim, mirëpo të njëjtat nuk ishin relevante për këtë çështje përbarimore, pasi që dokumenti përbarimor mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përbarimor është në gjuhë të huaj, i njëjti nuk ishte i përkthyer në njërin nga gjuhët zyrtare, andaj në pamundësi të vlerësimit të dokumentit përbarimor, pretendime tjera mbeten të pa shqyrtuara.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore si dhe

nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1573/22, datë 07.06.2024

Gjyqtari  
Gent Bekeri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.